

V E N D I M
Nr. 125, datë 24.3.1999

**PËR KOMPLETIMIN ORGANIK ME USHTARË RROGËTARË TË POLICISË KUFITARE
NË SISTEMIN E MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK**

Nisur nga situata në rajonet kufitare të Republikës së Shqipërisë, nga mungesat e plotësimit organik të strukturave të policisë kufitare dhe në mbështetje të ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Rendit Publik, bazuar në nevojat që ka, dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe me organet e pushtetit lokal, të marrë masa për rekrutimin e ushtarëve me pagesë.

2. Rekrutimi të bëhet nga radhët e kandidatëve që kanë kryer shërbimin e detyruar ushtarak dhe me moshë deri në 40 vjeç.

Rekrutimi realizohet në bazë të një kontrate, që lidhet ndërmjet kandidatit dhe përfaqësuesit të komisiariatit të policisë, për një afat kohor deri në 6 muaj, me të drejtë përsëritje.

3. Ushtarakët e rekrutuar përfitojnë pagën bazë të funksionit "polic" në policinë kufitare, shtesë për vështirësi shërbimi, në masën 50 përqind të pagës bazë, shtesën për vjetërsi në punë dhe shpërblimin për gradën rreshter I.

Atyre u sigurohet veshmbathje, ushqim dhe fjetje pa pagesë.

4. Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik, për vitin 1999, shtohen 17 (shtatëmbëdhjetë) milionë lekë.

5. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij vendimi.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko